



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DIBER
DREJTORIA EKONOMIKE
Sektori i Financës**

PROJEKT - V E N D I M

Nr. ____ Date ____ / ____ /2021

“Për përdorimin e fondit Rezerve, nga Granti dhe të Ardhurat”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.160 datë 30.12.2021, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin , nr.32/1 prot. datë 14.01.2021:

Kërkojmë:


- I. Nga fondi rezervë, nga Granti & të Ardhurat, me propozim të anëtravë të Këshillit Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës 11.10.2021 u vendos që të trajtohet me mbështetje financiare në festivalin Mbarëkombëtar “Oda Dibrane” 2021 “Ansambli Dibra “Përparim Tomçini”” në vlerën e 100,000 (njëqindmijë) lekë.
- I. Pakësohet fondi rezervë nga granti dhe të ardhurat për strukturën **1810** në vlerën 100,000 (njëqindmijë) lekë dhe shtohet struktura **1110** llogaria **604** ne vleren 100,000 (njëqindmijë) lekë.
- II. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.
- III. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.


PËR BASHKINË DIBËR:

P/Sektorit Juridik
Elona LUSHA

Drejtor Ekonomik
Lorenc Cibaku

KRYETARI I BASHKISË NË DETYRË
Shkëlqim MURRJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR
DREJTORIA EKONOMIKE
Spektori i Financës

Drejtuar: Prefektit të Qarkut Dibër

Relacion në lidhje me vendimin nr. 43 datë 11.10.2021

Në lidhje me vendimin nr.43 datë 11.10.2021 "Për miratimin e dhënies së një ndihme financiare për Shoqatën Kulturore Artistike "Oda Dibrane" për festivalin Mbarëkombëtar për vitin 2021, pas kërkesës së ardhur me nr.12 prot. datë 24.05.2021 e protokolluar nga ana jonë me shkresën nr.1734 prot. datë 24.05.2021, është marrë në shqyrtim nga ana e bashkisë Dibër për tu mbështetur financiarisht. Duke qënë që festivali i "Odës Dibrane" mbart vlera artistike, kulturore dhe kontribuon në nxjerrjen në pah të vlearve të trashëgimisë kulturore të krahinës sonë dhe më gjerë, bashkia morri përsipër që ta mbështesë financiarisht këtë aktivitet sipas udhëzimit për zbatimin e buxhetit. Me anë të projekt-vendimit nr.43 datë 11.10.2021 u kërkua miratimi i këtij fondi nga "Fondi rezervë nga granti dhe të ardhurat" në vlerën 500.000 (pesëqindmijë) lekë.

Drejtori Ekonomik
Lorenc CIBAKU



23.10.2021

826/11

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM NR 46 Datë 11.10.2021

“Për përdorimin e fondit Rezerve, nga Granti dhe të Ardhurat”


Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.160 datë 30.12.2020, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin , nr.32/1 prot. datë 14.01.2021: Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës 11.10.2021 miratoi me 16 vota pro 0 kunder 0 apstenim.

VENDIM:

1. Nga fondi rezervë, nga Granti & të Ardhurat, t’i jepet shpërblim financiare për Ansamblin ”Perparim Tomcini ”sipas listës bashkangjitur: Për cmimin e parë 100.000 (njëqindmijë) lekë.
2. Pakësohet fondit rezervë nga granti dhe të ardhurat për strukturën **1810** në vlerën 100.000 (njëqindmijë) lekë dhe shtohet struktura **1110** llogaria **604** në vlerën 100.000 (njëqindmijë) lekë.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër
4. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Ekonomike Sektori i financës.
5. U shpall sot me datë **11.10.2021**

Kryetar Këshilli

Sokol Sava





3428/ 26/10/21

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.978/1.prot.

Peshkopi, më 25.10.2021

Lënda : Per vendimin nr. 46, datë 11.10.2021 të Këshillit të Bashkisë Dibër

Drejtuar : BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.46, date 11.10.2021 "Për përdorimin e fondit Rezervë nga Granti dhe të Ardhurat, për Ansamblin Përparim Tomçini", në masën e 100.000 lekëve, konstatova se akti administrativ objekt verifikimi dhe shqyrtimi për dhënie ndihme financiare subjekteve apo personave të përcaktuar individualisht, bën pjese në kategorinë e akteve të karakterit individual, për pasojë Prefekti nisur nga fakti se akti administrativ është depozituar pranë nesh miraton në parim një vendimmarrje të tillë që për të gjitha efektet e ligjit është përgjegjësi direkte administrativo- ligjore e strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër që paraqesin për miratim projekt-vendime të kësaj natyre, duke ju terhequr përsëri vemendjen për mos përmbushjen e detyrimit ligjor lidhur me dokumentacionin shoqerues që duhet ti bashkëlidhet vendimit.

